



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

10. Markelian Koça (anëtar)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

7. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

9. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Po fillojmë mbledhjen e radhës, të KLGJ-së të datës 7 shkurt.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje për 10 çështje.

Nëse jemi dakord me përmbajtjen e rendit të ditës, unë do të sugjeroja që të kalonim në çështjen e parë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me miratimin raportit vjetor për veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ky është një detyrim ligjor që ka secili nga komisionet e përhershme në Këshill për të hartuar raportin e veprimtarisë së tyre, që në fakt do të jetë pjesë edhe e raportit vjetor që ka filluar puna për raportimin vjetor të Këshillit dhe që shpjegon veprimtarinë e

secilit komision.

Gjithashtu është parashikuar që secili raport të publikohet në faqen e internetit.

Pa diskutim që hartimi i raportit vjetor, krahas detyrimit ligjor, është një proces vetëreflektimi ku vlerësohen përveç arritjeve, sfidat dhe mundësitë që e ardhmja sjell në funksion të garantimit të një sistemi gjyqësor funksional dhe eficient si nga pikëpamja menaxheriale, administrative, ashtu edhe e burimeve njerëzore.

Në fakt viti 2023 është një vit transformimi për sistemin gjyqësor, për shkak të zbatimit të hartës së re gjyqësore, miratuar me VKM Nr. 495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”. Riorganizimi i kompetencave tokësore të gjykatave passolli një seri ndryshimesh si në aspektin ligjor ashtu edhe atë administrativ, ndryshime këto të cilat janë reflektuar në veprimtarinë e Komisionit, si struktura përgjegjëse brenda Këshillit të Lartë Gjyqësor për garantimin e mirëfunksionimit të sistemit gjyqësor nga perspektiva e administrimit financiar.

Në fakt unë kam thënë këtu që është reflektuar në veprimtarinë e komisionit por në fakt nuk është një punë e mirëfilltë e komisionit, por është puna e tre kolegëve tanë dhe e një grupi pune, që një pjesë e tyre nuk janë, kështu që unë dua ta përmend punën që ato kanë bërë, është zoti Ilir Rusi, është zonja {...} dhe zonja {...}, të cilët kanë bërë të mundur që zbatimi i hartës së re gjyqësore të bëhet sipas afateve që përcaktoheshin nga VKM-ja duke passjellë një mirëfunksionim të sistemit dhe asnjë problematikë në zbatimin e saj dhe prandaj gjej rastin që t’i falënderoj të tre për punën shumë të mirë që kanë bërë në këtë proces shumë të komplikuar dhe të zbatuar për herë të parë.

Si për çdo vit, raporti vjetor ofron një përshkrim të detajuar të veprimtarisë së Komisionit, qofshin këto cilësore ashtu edhe sasiore, duke nxjerrë në pah vendimmarrjet më të rëndësishme në aspektin e mirë-administrimit të sistemit gjyqësor nga pikëpamja e efikasitetit dhe transparencës, zhvillimeve në infrastrukturën teknologjike, si dhe menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare. Një vëmendje e veçantë në këtë raport i është kushtuar identifikimit të arritjeve, të cilat kanë shënuar rrugëtimin e Komisionit gjatë vitit që shkoi, po edhe atë angazhimeve për të ardhmen, të cilat do të jenë busulla orientuese për veprimtarinë e Komisionit në vitin 2024.

Komisioni, në ushtrimin e kompetencave të veta, luan një rol të qenësishëm në përmbushjen e misionit madhor të Këshillit të Lartë Gjyqësor në qeverisjen, mbarëvajtjen dhe miradministrimin e sistemit gjyqësor në vendin tonë. Sikurse është përmendur edhe në raportet e mëparshme vjetore, kuadri ligjor i ka atribuar Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit kompetenca të rëndësishme në tre nivele:

I. Nivelin Strategjik;

II. Nivelin Administrativo – menaxherial;

III. Nivelin e politikave buxhetore dhe financiare, funksion i cili del në pah veçanërisht gjatë procesit të planifikimit të projektbuxhetit afatmesëm (PBA), negocimit dhe monitorimit. Në kuadër të kësaj kompetence ligjore, komisioni është përgjegjëse edhe për hartimin, miratimin dhe monitorimin e politikave buxhetore dhe financiare për Këshillin dhe sistemin gjyqësor dhe për QTI-në.

Në ushtrim të këtyre kompetencave, Komisioni gjatë vitit 2023 ka realizuar 45 mbledhje, në të cilat janë marrë rreth 119 vendime, 110 prej të cilave në fushat përkatëse të veprimtarisë si më poshtë vijon:

-12 në fushën e planifikimit strategjik;

-81 në fushën e administrimit dhe efikasitetit;

-17 në fushën e programimit dhe menaxhimit financiar dhe buxhetor.

Ndërkohë, 9 vendimmarrje të Komisionit i referohen miratimit të procesverbaleve të mbledhjeve plenare, në përputhje me detyrimin ligjor që ka Këshilli përkundrejt transparencës në marrëdhëniet me publikun dhe llogaridhënies përkundrejt qytetarëve.

Vendimmarrjet e Komisionit, si në numër ashtu edhe në cilësi dëshmojnë angazhimin maksimal për të mundur zbatimin me sukses të projektit më madhor të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që është zbatimi i hartës gjyqësore. I udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, integritetit, dhe paanshmërisë Komisioni ka vijuar punën për të garantuar përmbushjen e përgjegjësive ligjore por njëkohësisht ka dëshmuar edhe fleksibilitet në reagimin në kohën e duhur dhe me mjetet e nevojshme ndaj problematikave të evidentuara në sistemin gjyqësor.

Si strukturë e përhershme, veprimtaria e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit është e ndërlidhur me veprimtarinë dhe funksionin edhe të

komisioneve të tjera të Këshillit, ndërveprim ky, i cili evidentohet sidomos në funksion të ndërtimit të një administrate civile gjyqësore profesionale dhe arritjes së standardeve të ekselencës gjyqësore.

Disa prej arritjeve më të theksuara të punës së tij janë:

-119 akte/vendime të hartuara dhe miratuara.

-Një paketë e plotë prej 60 aktesh administrative dhe individuale, që mundësuan zbatimin me sukses të hartës së re gjyqësore për riorganizimin e kompetencave tokësore të 38 gjykata në 20 të tilla.

-Vazhdimi i zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor përmes vendosjes të standardeve të unifikuara të administrimit të brendshëm gjyqësor me miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë nëpër gjykata.

-Vijimi i misionit për garantimin e profesionalizimit, integritetit dhe llogaridhënies së nëpunësve civilë gjyqësorë përmes:

o Zhvillimit dhe përfundimit të procedurave për verifikimin e 7 kancelarëve në detyrë si dhe të 4 nëpunësve civilë gjyqësorë, 3 ndihmës ligjorë në njësinë e shërbimit ligjor në gjykatat e apeleve dhe 1 këshilltar ligjor pranë njësisë së shërbimit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

-Realizimi i buxhetit për sistemin gjyqësor në masën 96% , duke reaguar me fleksibilitet ndaj nevojave të sistemit gjyqësor në kushtet e ndryshimeve ligjore dhe administrative të imponuara nga riorganizimi i sistemit si dhe nga ndryshimet në kategorizimin e pagave në administratën publike.

-Vazhdimi i përpjekjeve për rritjen e transparencës, aksesit dhe besimit të publikut mbi veprimtarinë gjyqësore duke standardizuar marrëdhëniet e gjykatave me publikun dhe median përmes miratimit të udhëzuesit standard si dhe rritjes së numrit të gjyqtarëve të medias nga 8 në 17 të tillë, që mbulojnë juridiksionin e përgjithshëm dhe posaçëm për të dyja nivelet e gjykimit. Edhe për këtë çështje në fakt dëshiroj të përmend që ka qenë një punë e palodhur e zonjës {...} e cila ishte pjesë e Komisionit tonë dhe ishte personi i caktuar nga Këshilli për median dhe patjetër që është punë e reflektuar edhe nga Komisioni sepse ishte ajo iniciatorja dhe propozuesja e këtyre projekt-akteve.

-Vijimi i angazhimit në funksion të rritjes së transparencës dhe efijçencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit nga departamenti pranë KLGJ-së.

o Mundësimi i zhvillimeve të reja si dhe trajtimi i 1027 kërkesave për mbështetje teknike.

o Përfundimi me sukses i migrimit të të gjithë bazës së të dhënave nga gjykatat që ndërprejnë veprimtarinë, për shkak të riorganizimit, në gjykatat pritëse.

o Përfundimi i digjitalizimit të arkivës për 8 gjykata .

o Anonimizimi automatik i të dhënave sensitive në vendimet gjyqësore, duke ekuilibruar nga njëra anë nevojën e shtuar për transparencë dhe akses në gjyqësor dhe nga ana tjetër mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

o Disiplinimi i procedurave të shortit me qëllim garantimin e transparencës dhe shpërndarjes së barabartë të ngarkesës së gjyqtarëve.

Dua të përmend që për herë të parë, për shkak të kërkesës së ardhur nga media dhe e propozuar nga zonja Shehu, u përfshi edhe mbledhja e të dhënave në mënyrë elektronike për të gjithë paditë që janë palë mediat.

-Funksionalizimi i Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, përmes plotësimit të organikës së saj dhe hartimit të dokumenteve kornizë për ndërtimin e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve gjyqësore për të gjithë sistemin e drejtësisë.

Në kuadrin e kryerjes së bilancit të fundvitit 2023, dhe në njohje të plotë të rolit dhe funksioneve të tij, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, do të vazhdojë punën e tij me përgjegjësi e përkushtim dhe përgjatë vitit 2024 duke marrë angazhimet si më poshtë vijon:

1. Plotësimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm përmes hartimit dhe miratimit të akteve në funksion të rritjes së efijçencës dhe performancës së sistemit gjyqësor, me fokus përmirësimin e cilësisë së shërbimeve gjyqësore për publikun.

2. Vazhdimin e zbatimit të reformës për nëpunësin civil gjyqësor si një pjesë tjetër tashmë e prioriteteve tona duke miratuar akte siç janë:

o Hartimi dhe miratimi i rregullores për procedurat disiplinore për nëpunësin civil gjyqësor (rregullore që tashmë ne e kemi miratuar).

o Hartimi dhe miratimi i rregullores për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë.

o si dhe zhvillimi i vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë gjyqësorë.

3. Hartimin e kërkesave buxhetore realiste si për vitin e ardhshëm dhe për buxhetin afatmesëm të sistemit gjyqësor në përputhje me monitorimin tashmë të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore dhe impaktit të saj.

o Sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm me qëllim identifikimin e nevojave për burime financiare dhe burime njerëzore në sistemin gjyqësor.

4. Menaxhimin e fondeve buxhetore të alokuara me efikasitet dhe efektivitet për sistemin gjyqësor, përfshirë KLGJ-në, QTI-në dhe gjykatat dhe ndjekja e monitorimi i tyre.

o Miratimi i rregullores së menaxhimit të aktivëve për të gjithë sistemin gjyqësor, sipas legjisllacionit për menaxhimin e aktivëve në sektorin publik.

5. Monitorimin permanent të nevojave të sistemit gjyqësor si për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit aktual të menaxhimit të çështjeve.

6. Fuqizimin e përpjekjeve për të vijuar rritjen e transparencës mbi sistemin gjyqësor përmes, ndër të tjerave, edhe zhvillimeve teknologjike dhe digjitalizimit të shërbimeve gjyqësore.

7. Rritja e kapaciteteve të infrastrukturës IT lidhur me menaxhimin e rrezikut të sigurisë kibernetike, duke identifikuar dhe adresuar rreziqet potenciale dhe duke pasur një plan të përgatitur për rikuperim, si dhe marrjen e masave për identifikimin dhe përballimin e incidenteve të mundshme kibernetike.

8. Forcimin e bashkëpunimit me donatorët dhe projektet e ndihmës së huaj me qëllim sigurimin e fondeve dhe asistencës së nevojshme për zhvillimin e një sistemi të ri e bashkëkohor të teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë.

Kjo ishte shkurtimisht e gjithë puna, veprimtaria e kryer nga ana e Komisionit.

Po!

Alban Toro: Atëherë, kjo ka formën e rekomandimit dhe nuk është se kam

vërejtje për pjesën e raportit.

Do të dëshiroja të shikoja në raport çështjet e mprehta që kemi pasur dhe kemi në lidhje me administrimin e fondit buxhetor që na ka vlerësuar Parlamenti. Jo pak herë është bërë problematikë në Këshill, kur fondi buxhetor bllokohej pa asnjë shkak nga Ministria e Financave. Normalisht duhet të ishte përfshirë tek raporti juaj.

Nuk ka nevojë ta shkurtojmë këtë pjesë sepse nesër-pasnesër, të gjithë problemet që ka sistemi i drejtësisë i adresohen Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mirë mungesa e faturës financiare që duhet të shoqëronte hartën e re gjyqësore, që nuk u shoqërua asnjëherë harta e re gjyqësore me faturë financiare dhe u detyruam që të marrim fondet e dikujt tjetër, i cili kishte shumë nevojë, dhe t'i përdornim për efekt të hartës gjyqësore.

Natyrisht ky qëndrim refraktar i Ministrisë së Financave nuk është se është në përputhje me ligjin, por që ju ka kërkuar jo pak mund në korrespondencë për të adresuar që ai fond të bëhej i aksesueshëm nga KLGJ-ja. Teorikisht, këtu duhet të ishte evidentuar me shkronja të mëdha, jo me pak fjalë, e gjithë ajo problematikë, sepse po të shikojmë sot mungesën e fondeve, e trojeve për gjykatat, ato nuk janë zyra gjyqtarësh, fillo nga Gjykata e Rrethit Tiranë, shko tek Gjykata e Apelit, ne pretendojmë t'i çojmë në 80 veta, aty nuk ka vend për ato që janë aty (25 veta). Nuk janë zyra.

Shkojmë tek Gjykata e Tiranës (si dhoma civile dhe penale), kanë nevojë imediate për përmirësimin e infrastrukturës gjyqësore e cila do të duhet të shoqërohet me troje, pra ose në truallin ekzistues të ndërtoheshin/të zgjeroheshin, në mënyrë që ato të bëheshin sa më dinjitoze për gjyqtarin, por edhe sa më të aksesueshëm për njerëzit të cilët presin të përfitojnë nga sistemi i drejtësisë.

E gjithë kjo problematikë natyrisht që përputhet me qëndrimin refraktar të Ministrisë së Financave dhe ndoshta ka ardhur momenti që ne të adresojmë ndryshime të ligjit dhe të mos kemi më intelektual për miratimin e buxhetit Ministrinë e Financave, por drejtpërdrejt Parlamentin.

Në këto kushte unë e shikoj imediate që e vetmja zgjidhje për këtë pjesë të jetë Parlamenti ai që të miratojë fondin dhe ne të kemi intelektual të vetëm, duke anashkaluar Ministrinë e Financave, Parlamentin. Vetëm kështu do të mund të arrihet pavarësia. Dhe

normalisht, të gjitha këto problematika, do duhet të evidentoheshin në raport me germa të mëdha. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit për sugjerimin.

Në fakt shqetësimi që ju ngrini është me të drejtë. Nuk është se nuk është vlerësuar edhe nga Komisioni, por Komisioni në këtë pjesë, ka raportim vetëm pjesën se si ka menaxhuar ato fonde që i janë dhënë dhe janë administruar. Por kjo s' do të thotë që ne nuk kemi reaguar ndaj nevojave që ka sistemi dhe vazhdojmë reagojmë. Pa diskutim që ne mund ta shtojmë një rekomandim sipas propozimit tuaj, lidhur me pjesën e nevojës që duhet t'i parashtrijmë Ministrisë së Financave, ku në mënyrë shkresore dhe në mënyrë informale, kjo nevojë është paraqitur disa herë, por nuk është në vendimmarrjen tonë, është në vendimmarrjen e autoriteteve të tjera. Në raport patjetër që mund ta reflektojmë në formë rekomandimi.

Ndonjë diskutim tjetër?

(Nuk ka diskutime.)

Faleminderit!

Në qoftë se nuk ka diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit të Planifikimit

Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për vitin 2023, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi, duke u shtuar edhe rekomandimi që bëri zoti Toro.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2023””, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
10. ***Markelian Koça*** (anëtar)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

7. Arturo Valdes dhe Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

9. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2023””, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e dytë e cila ka të bëjë me miratimin e “Raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2023”. Shkurtimisht do prezantohet nga Kryetari i Komisionit, z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Shkurtimisht po bëj edhe unë një prezantim në lidhje me veprimtarinë njëvjeçare të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Procedurat e ngritjes në detyrë. Fillimisht për Gjykatën e Lartë procedurat e ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqësorit.

Këshilli, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, mbi propozimet e KZHK-së ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 3 pozicione të lira gjatë vitit 2021, nga të cilat 2 (dy) pozicion në fushën e të drejtës civile dhe 1 (një) pozicion pozicione në fushën e të drejtës administrative. Në vijim Komisioni ka hapur një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, për shkak të përfundimit të mandatit të z. Bici të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022.

Në përfundim, në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, gjatë vitit 2023, ka rezultuar të jenë miratuar:

- 1 (një) akt administrativ individual për kualifikimin e kandidatëve për në Gjykatën e Lartë dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet përkatëse;

- 3 (tre) akte administrative kolektive për propozimin për emërim në Gjykatën Lartë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, për propozimin për emërim në Gjykatën Lartë për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 536, nr. 537 datë 17.11.2021.

- 3 (tre) akte administrative individuale për miratim propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve.

Procedura e ngritjes në detyrë që ndërmerret nga KZHK-ja normalisht përputhet dhe koordinohet edhe me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për pozicionet e shpallura me vendimet e përmendura më lart. Kjo kohë e koordinimit të punës së komisionit tonë me komisionin e vlerësimit etik dhe profesional konsumoi një kohë relativisht të gjatë derisa arritëm në përfundimin e vendimmarrjes që kemi marrë për ngritjen në detyrë të tre gjyqtarëve që tashmë ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë.

Pengesa e dytë që kemi hasur: Aktet e miratuara nga Këshilli për propozimin për emërim u ankimuan nga gjyqtarë të përfshirë në këtë procedurë. Si pasojë procedura u

shty deri në marrjen formë të prerë të këtyre vendimeve;

Komisioni ka përfunduar detyrimet ligjore lidhur me kandidatët e përfshirë në pozicionin penal të mbetur vakant. Pritet vendimmarrja e Këshillit lidhur me kualifikimet/skualifikimet e 2 (dy) kandidatëve që ne i kemi dërguar në Këshill.

Për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, kemi zhvilluar procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Lidhur me këtë veprimtari, ne kemi nxjerrë përfundimet të cilat po i lexoj përpara Këshillit:

- 1 (një) akt administrativ kolektiv për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 14 (katërbëdhjetë) akte administrative individuale, nga të cilat 13 (trembëdhjetë) për verifikimin e plotësimit të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 1 (një) për kualifikimin e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- 1 (një) akt administrativ individual për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet përkatëse.

- 1 (një) akt administrativ kolektiv, për përzgjedhjen për ngritjen në detyrë të kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 3 (tre) akte administrative kolektive për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- 3 (tre) akte administrative individuale, për ngritjen në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Pengesat e hasura:

- Procesi i verifikimit të pasurisë dhe të figurës për kandidatët që kërkojnë të ngrihen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar në bazë të ligjit realizohet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, që ushtron funksionet dhe veprimtarinë e tij verifikuese pranë institucioneve që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar. Pra jemi tek godina ku ushtrojnë aktivitetin sot gjykatat e posaçme dhe SPAK-u. Ata krijojnë komisionin e posaçëm që bëjnë verifikimin e pasurisë dhe të figurës për kandidatët që kandidojnë në pozicionet e lira të shpallura nga KLGJ-ja.

- Procesi i verifikimit të pasurisë e figurës për këta kandidatë, është një ndër kushtet e nevojshme për kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurës së mëtejshme nga ana e Komisionit. Pra presim rezultatet e tyre për të vijuar më tej veprimtarinë tonë. Ky proces i cili nuk është përfunduar ende nga Komisioni i Posaçëm ka ndikuar në kohëzgjatjen e kësaj procedure.

Për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës administrative të apelit.

Përfundime në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit gjatë vitit 2023, nga ku rezulton se janë miratuar:

- 13 (trembëdhjetë) akte administrative kolektive, akte për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;

- 1 (një) akt administrativ kolektiv për fillimin e procedurave të verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

- 34 (tridhjetë e katër) akte administrative individuale nga të cilat 18 (tetëmbëdhjetë) për verifikimin e plotësimit të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) për kualifikimin e kandidatëve në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;

- 7 (shtatë) akte administrative individuale për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet

përkatëse.

- 5 (pesë) akte administrative individuale nga të cilat 3 (tre) akte janë për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 2 (dy) akt për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

- 1 (një) akt administrativ kolektiv për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- 5 (pesë) akte administrative individuale nga të cilat 3 (tre) akte janë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe 2 (dy) akte për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Edhe në këtë rast problemet hasen në lidhje me koordinimin e veprimtarisë së komisionit tonë me komisionin e vlerësimit etik që kanë të bëjnë me çështjet e kualifikimit të kandidatëve dhe çështjet që lidhen me vlerësimin etik dhe profesional të tyre, pasi janë kritere ligjore që duhen për të bërë përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në këto gjykata.

Në lidhje me çështjen mbi bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës.

Përfundime në lidhje me bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe për ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024, rezulton se janë miratuar:

- 1 (një) akt administrativ kolektiv mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024.

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës në kuadër të verifikimit të kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magjistratë në Shkollën e Magjistraturës.

Janë arritur të hartohen • 35 (tridhjetë e pesë) akte administrative individuale kualifikuese për kandidatët për magjistratë, raste që i referohen rasteve të kualifikimit të kandidatëve për magjistratë nga të cilat 1 (një) i kualifikuar kandidat për magjistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2021-2022, 4 (katër) kandidatë për magjistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik

2022-2023 si dhe 30 (tridhjetë) kandidatë për magistratë, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024;

- 1 (një) akt administrativ individual për skualifikimin e kandidatit për magistrat, profili gjyqtar, për në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2021-2022;

- 1 (një) akt administrative kolektiv me anë të cilit Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024.

- 1 (një) akt mbi shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm për pezullim të procedurës së verifikimit.

Pengesat e hasura:

- Një pjesë e periudhës së verifikimit përkoi me muajin gusht, gjatë të cilit subjektet publike dhe private funksionojnë me personel të reduktuar për shkak të kryerjes nga punonjësit të pushimeve vjetore, çka ka sjellë vonesa të dërgimit të informacioneve dhe raportimeve të kërkuara nga Këshilli;

- Nevoja për verifikime të mëtejshme për shkak të konstatimeve të hasura gjatë procedurës për verifikimin e kriterit të pasurisë dhe figurës. Pra ka pasur raste kur procedura për verifikimin e pasurisë dhe figurës ka qenë komplekse dhe ka pasur nevojë dhe kohë për kryer veprime të tjera shtesë.

- Si dhe sugjerimet që ne kemi bërë si Komision për mungesën e këshilltarit auditues financiar i cili do të mundësonte plotësimin në kohë me njohuri në fusha të specializuar në lidhje me verifikimin e kriterit të pasurisë dhe figurës në disa raste kur ne çmojmë se ajo mund të na shërbejë për të përfunduar në kohën e duhur verifikimet për pasurinë ndaj kandidatëve që kemi në proces verifikimi.

Mbi emërimin e magistratëve – Emërimi i magistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2022-2023.

Në lidhje me procedurat për emërimin e magistratëve që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022 dhe vitin 2022-2023, ka rezultuar se janë miratuar:

- 3 (dy) akte administrative kolektive nga të cilat, 1 (një) për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar, të kandidatëve për

magjistratë, profili gjyqtar dhe 2 (dy) akte administrative kolektive për shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit nga Shkolla e Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022 dhe vitin 2022-2023;

- 123 (njëqind e njëzet e tre) akte administrative individuale, nga të cilat 41 (dyzet e një) vendime për kualifikimin për emërim të kandidatëve të diplomuar, 41 (dyzet e një) vendime për emërimin gjyqtar si dhe 41 (dyzet e një) vendime për caktimin në pozicion të gjyqtarëve të sapo emëruar.

Mbi skemën e delegimit - në lidhje me caktimin e gjyqtarëve në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit, janë miratuar këto akte:

- 12 (dymbëdhjetë) akte administrative individuale, nga të cilat 4 (katër) vendime për caktimin e gjyqtarëve në skemën e delegimit, 1 (një) vendim për zgjatjen e afatit të caktimit të gjyqtarëve të skemës së delegimit, 1 (një) vendim për ricaktimin e gjyqtarëve të skemës së delegimit, 6 (gjashtë) vendime për përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit.

- 4 (katër) akte administrative individuale për caktimin e gjyqtarëve të skemës së delegimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Mbi rastet e komandimit të gjyqtarëve - Përfundime në lidhje me gjyqtarët e komanduar përgjatë vitit 2023, rezulton se janë miratuar këto akte:

- 21 (njëzet e një) akte administrative kolektive për hapjen dhe/ose rihapjen/përfundimin e procedurave të komandimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Drejtësisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese dhe Shkollën e Magjistraturës.

- 7 (shtatë) akte administrative individuale në kuadër të procedurës së komandimit/përsëritjes së komandimit dhe përfundimit të kohëzgjatjes së saj, në Gjykatën e Lartë, Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Mbi transferimin e gjyqtarëve - Përfundime në lidhje me gjyqtarët e transferuar përkohësisht përgjatë vitit 2023, ka rezulton se janë miratuar këto akte:

- 14 (katërmëdhjetë) akte administrative kolektive për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm në gjykata;

- 16 (gjashtëmbëdhjetë) akte administrative individuale, prej të cilave 12

(dymbëdhjetë) akte për transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarëve, 2 (dy) akte administrative individuale për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve në gjykata të ndryshme, 2 (dy) akt për përfundimin para afateve të transferimit të përkohshëm.

Transferimi i përhershëm i gjyqtarëve sipas nenit 42 të Ligjit për Statusin - Përfundime në lidhje me gjyqtarët e transferuar në mënyrë të përhershëm përgjatë vitit 2023, rezulton se në lidhje me këtë çështje janë miratuar këto akte:

- 8 (tetë) akte administrative kolektive, për fillimin/ustrimin e të drejtës së zgjedhjes për transferim të gjyqtarëve për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatat;
- 8 (tetë) akte administrative individuale, për transferimin e gjyqtarë në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Transferimi i përhershëm i gjyqtarëve nëpërmjet “procedurës së lëvizjes paralele” sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin – Përfundime në lidhje me procedurat e lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm gjatë vitit 2023, rezulton se janë miratuar këto akte:

- 25 (njëzet e pesë) akte administrative kolektive, akte për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- 5 (pesë) akt administrativ kolektive, për fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- 30 (tridhjetë) akte administrative individuale, për kualifikimin e kandidatëve në procedurat e lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- 15 (pesëmbëdhjetë) akte administrative individuale, për përfundimin e procedurave të lëvizjes paralele, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi në pozicionet përkatëse;
- 2 (dy) akte administrative kolektive, për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për lëvizjet paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.
- 12 (dymbëdhjetë) akte administrative individuale, për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm

- 11 (njëmbëdhjetë) akte administrative individuale, për transferimin e gjyqtarëve për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Mbi mbarimin e statusit të magjistratit – Përfundime në lidhje me dorëheqjet e paraqitura nga gjyqtarët përgjatë vitit 2023, nga ku rezulton se janë miratuar:

- 6 (gjashtë) akte administrative individuale për mbarimin e statusit të gjyqtarëve për shkak të paraqitjes së dorëheqjes dhe për miratimin e pensionit të parakohshëm/moshës së pensionit.

Mbi caktimin e gjyqtarëve në çështje të veçanta – Përfundime në lidhje me trajtimin e kërkesave për caktim gjyqtari përgjatë vitit 2023, nga ku ka rezultuar se janë miratuar:

- 31 (tridhjetë e një) akte administrative kolektive gjithsej; nga të cilat 26 (gjashtëdhjetë e gjashtë) akte administrative nëpërmjet të cilave janë trajtuar 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) kërkesa për caktim gjyqtari dhe në përgjigje të tyre janë caktuar 208 (dyqind e tetë) gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme;

- 1 (një) akt mbi ndryshimin e pjesshëm të akteve;
- 4 (katër) akte lidhur me kërkesa të tjera të paraqitura pranë Komisionit.

Vlen të theksohet se përgjatë vitit 2023 kur implementimi i hartës gjyqësore është bërë aktiv, numri i kërkesave për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme, nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, ka rënë në mënyrë të ndjeshme, krahasuar me vitet e kaluara, përpara se të implementohej harta e re gjyqësore.

Mbi çështje të tjera - Përveç sa më sipër, KZHK-ja ka trajtuar si dhe ka kaluar për shqyrtim në Këshill edhe disa çështje të tjera që lidhen me fushën e veprimtarisë së tij, për të cilat Këshilli ka miratuar 4 (katër) vendimmarrje. Ndërmjet këtyre vendimmarrjeve, vlen të theksohet projekt-akti i propozuar në Këshill që lidhet me miratimin e rregullave për emërimin e kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Pas miratimit të rregullave nga Këshilli, Gjykata e Lartë ka vijuar më tej

procedurën nga e cila ka rezultuar se është përzgjedhur kryetari i Gjykatës së Lartë referuar rregullave që ne kemi miratuar si Këshill në vitin 2023.

Përfundime:

Gjatë vitit 2023, mbi projektvendime të propozuara nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar gjithsej 484 vendime, nga të cilat:

-88 vendime në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit;

-1 vendim në kuadër të procedurës së përcaktimit të numrit të kandidatëve për gjyqtarë dhe ndihmës ligjorë që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023-2024;

-6 vendime në kuadër të procedurave të mbarimit të statusit të magjistratit (për shkak pensioni ose dorëheqje);

-28 vendime në kuadër të procedurave të komandimit të gjyqtarëve;

-16 vendime në kuadër të procedurave të skemës së delegimit të ngritur pranë Këshillit sipas nenit 45 të Ligjit për Statusin;

-146 vendime në kuadër të procedurave të transferimit të përkohshëm dhe të përhershëm të gjyqtarëve;

-126 vendime në kuadër të procedurave të emërimit të magjistratëve;

-38 vendime në kuadër të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit për në formimin fillestar, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës (në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2021-2022; 2022-2023 dhe në lidhje me kandidatët e shpallur fitues për vitin akademik 2023-2024);

-31 vendime në kuadër të procedurave të caktimit të gjyqtarëve në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, nga të cilat 27 vendime nëpërmjet të cilave janë trajtuar 169 kërkesa;

-4 vendime në kuadër të procedurave të tjera të lidhura me statusin dhe karrierën gjyqësore. Në këtë kategori përfshihet përmbushja e një ndër prioriteteve të Komisionit

për vitin 2023, e cila lidhet me hartimin e rregullave të detajuara për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Në mënyrë grafike ne kemi paraqitur edhe ecurinë e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitet 2019-2023. Vlen të përmendim se vitit 2023 është një vit i cili ka sjellë një numër të madh projektvendimesh dhe aktesh që ne kemi dërguar në Këshill, janë gjithsej 484 vendime, dhe në të gjithë veprimtarinë e KLGJ-së për KZHK-në është viti i dytë pas vitit 2020, si vit që ka sjellë dhe ka shtuar në maksimum numrin e projektvendimeve që ky Komision ka sjellë përpara Këshillit për miratim.

Objektivat për vitin 2024.

1. Miratimi i akteve nënligjore - Bazuar, në pikën 12, të nenit 52 të Ligjit për Statusin, KZHK do të duhet të hartojë dhe propozojë rregulla më të detajuara, që lidhen me ngritjen në detyrën e kryetarit të gjykatës (shkalla e parë edhe apel).

2. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve për një pozicion të lirë të shpallur përgjatë vitit 2022.

3. Përfundimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Hapja e procedurave të reja lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të përcaktuara si gjykata në nevojë.

5. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për caktimin e kuotave për magjistratë dhe ndihmës ligjorë për vitin akademik 2024-2025.

6. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për verifikimin me prioritet të kandidaturave, të cilat mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2024-2025 si dhe emërimin e magjistratëve që do të përfundojnë Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024.

7. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjykatat ku do të kërkohet caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta, në kushtet kur nëpër gjykata vijon krijimi i vakancave për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj gjyqtarëve.

8. Bashkëpunimi me institucionet e sistemit të drejtësisë nëpërmjet mekanizmit të komandimit të gjyqtarëve në funksion të mirëfunksionimit të këtyre institucioneve.

9. Trajtimin në kohë të kërkesave të ardhura nga gjyqtarët apo gjykatat e ndryshme që lidhen me çështje të karrierës gjyqësore.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë sugjerim.

Nëse jo, atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Përpara se sa ta votoj, më duhet të them se duhet të falënderoj në mënyrë të veçantë për kontributin e paçmuar në realizimin dhe konvertimin e 484 projektvendimeve në vendimmarrje të Këshillit, të ish-anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës z. {...}, znj. {...}, si edhe një vlerësim të veçantë komponentëve të njësisë ligjore, këshilltareve dhe të gjithë stafit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pa ndihmën e të cilëve nuk do të mund të përballohej një ngarkesë e tillë. Kontributi impenjimi, sakrificat e tyre ka mundësuar përballimin e sfidave të vështira me të cilën është përballuar sistemi i drejtësisë dhe përmbushja e detyrave tona kushtetuese duke ruajtur në çdo rast qetësinë, pozitivitetin dhe frymën e bashkëpunimit. Edhe unë jam dakord me projektraportin dhe me këtë falënderim që ne e ruajtmë për në fund për kolegët të cilët tashmë u ka mbaruar mandati dhe ushtrojnë detyrat e tyre në pozicionet përkatëse. Faleminderit!

Naureda Llagami: Dakord me projekt-aktin.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e “Raportit mbi veprimtarinë e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për vitin 2023”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi transferimin e dy automjeteve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)

10. Markelian Koça (anëtar)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi transferimin e dy automjeteve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktet e tjera që në fakt vijnë nga komisioni i administrimit të buxhetit dhe që do relatohen nga Drejtori i Departamentit të Buxhetit, që kanë të bëjnë, akti i parë me transferimin e dy automjeteve pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ju e dini shumë mirë që gjykatat e posaçme për shkak të pozicionit që ato kanë ligji i ka njohur jo vetëm të drejtën për vështirësinë e punës, por i ka njohur edhe të drejtën e mbrojtjes dhe të përdorimit të makinave nga ana e gjyqtareve të posaçëm. Ky është një nga adresimet e detyrimeve që ka Këshilli ndaj këtyre gjykatave, që me më shumë detaje do ta shpjegojë drejtori.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë, sikurse jeni në dijëni, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 476, datë 13.09.2023, “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve (autovetura) në sistemin gjyqësor”, miratoi transferimin e 4 automjeteve tip “Hyunday Elantra”, viti i prodhimit 2019 për plotësimin e nevojave të Gjykatës së Lartë.

Pas një periudhe katërmujore, Gjykata e Lartë, më datë 24.01.2024, tërhoqi vetëm 2 automjete nga 4 automjetet e miratuara nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor për këtë gjykatë.

Gjatë kësaj periudhe, me shkresën nr.38, datë 09.01.2024, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka paraqitur pranë KLGJ-së, kërkesë për t’u pajisur me 7 automjete.

Në këto kushte duke qenë se Gjykata e Lartë nuk tërhoqi dy nga automjetet e miratuara nga KLGJ-ja, vlerësojmë që 2 automjetet e ngelura të transferohen për të plotësuar këtë nevojë të vogël për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e transferimit të dy automjeteve tip “Hyunday Elantra”, të vit prodhimit 2019, në pronësi të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ju faleminderit për vëmendjen. Në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e transferimit të dy automjeteve tip “Hyunday Elantra” me targa AA 042 ZH dhe AA 175 ZH, viti i prodhimit 2019, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi detajimin e fondit të veçantë për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
10. ***Markelian Koça*** (anëtar)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi detajimin e fondit të veçantë për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin tjetër që edhe ky është me natyrë që lidhet me buxhetin. Detajimi i fondit të veçantë për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024. Sërish ia jap fjalën Drejtorit të Departamentit.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë, sikurse jeni në dijeni, me ligjin nr. 97/2023, “Për Buxhetin e vitit 2024”, është miratuar buxheti i shtetit, pjesë e të cilit është buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), i ndarë në tre programe buxhetore, programi 01110, programi 01140, dhe programi 03310 Buxheti Gjyqësor.

Fondi i veçantë i Njërive të Qeverisjes Qendrore nuk është pjesë e fondit të pagave të miratuar me ligjin e buxhetit vjetor. Në nenin 12, të ligjit nr.97/2023 “Për

Buxhetin e vitit 2024” përcakton se: Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 400 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

Me Udhëzimin Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të Ministrit të Financave, janë përcaktuar fondet për çdo njësi të qeverisjes qendrore, ku fondi i veçantë i miratuar për vitin 2024 për sistemin gjyqësor, është në vlerën prej 4 500 000 lekë.

Në zbatim të udhëzimit plotësues, nga ana e njësi të qeverisjes qendrore ky fond detajohet në nivel programi sipas strukturës përkatëse buxhetore në artikullin 606 dhe mbështetet në treguesin kryesor që është numri i punonjësve sipas programeve buxhetore. Pasi miratohet ky fond bëhet efektiv në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për Ministrinë e Financave. Sipas këtij udhëzimi, fondi do të jetë pjesë e njësisë shpenzuese të qeverisjes qendrore, në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar, për përballimin vetëm të shpenzimeve për ndihma të menjëhershme si ndihma për raste fatkeqësie, sëmundje dhe daljet në pension pleqërie, etj. Kërkesa për shpenzim së bashku me dokumentacionin përkatës paraqitet në degën e thesarit përkatës. Nëse gjatë vitit buxhetor këto fonde janë të pamjaftueshme, atëherë bëhet kërkesë për fonde shtesë pranë Ministrisë së Financave dhe që janë të detyruar të akordojnë fond shtesë në lidhje me këtë qëllim.

Fondi i veçantë për gjykatat e të gjitha niveleve, do të mbahet në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” dhe rast pas rasti do të kërkohet miratim pranë Ministrisë së Financave.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e detajimit të fondit të veçantë, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, për vitin 2024 në shumën prej 4.500.000 lekë, sipas programeve buxhetore, programin 01110, në shumën 1.200.000 lekë, programin 01140 në shumën 100.000 lekë dhe programin 03310 në shumën 3.200.000 lekë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ndonjë diskutim apo pyetje për drejtorin?

Nëse nuk kemi, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e detajimit të fondit të veçantë, për sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024, në vlerën prej 4.500.000 lekë, përkatësisht sipas programeve buxhetore:

- për programin 01110 në shumën 1.200.000 lekë.

- për programin 01140 në shumën 100.000 lekë.

- për programin 03310 në shumën 3.200.000 lekë.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar me vendimin nr. 602, datë 23.12.2021 dhe me vendimin nr. 88, datë 09.03.2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 15, datë 22.01.2019 “Mbi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i ndryshuar me vendimin nr. 602, datë 23.12.2021 dhe me vendimin nr. 88, datë 09.03.2022”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin e radhës.

Në fakt akti i radhës ka të bëjë me ndryshimin apo përditësimin e komisionit të përkohshëm që është ngritur nga ana e KLGJ-së që në fillimet e saj, pasi është komisioni përgjegjës për vlerësimin etik dhe profesional që i bëhej subjekteve të rivlerësimit kalimtar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Pra ky është një komision i cili ka

qenë ndihmues ndaj procesit të rivlerësimit.

Duke qenë se z. {...} i cili ishte anëtar i këtij Komisioni dhe i ka mbaruar mandati, komisioni funksionon me 5 veta, kështu që duhet zëvendësimi i z. {...}, i cili ishte jo vetëm anëtar, por edhe kryetar dhe ka menaxhuar komplet pjesën e vlerësimit profesional për qëllim të procesit të rivlerësimit. Ka ardhur koha që ne të bëjmë zëvendësimin e tij.

Nga praktikatat e mëparshme që ka pasur Këshilli, që në krijimin e këtij Komisioni, duke qenë se në kushtet që ne e kemi krijuar, vlerësuam të gjithë së bashku kush do merrte pjesë në të, ne nuk kemi aplikuar short, por e kemi ndarë midis njëri-tjetrit kush ka shprehur gatishmërinë për të kontribuar në këtë komision. Kështu që unë do propozoja fillimisht që nëse nga ana e gjyqtarëve, duke përjashtuar zotin Kurushi që është në këtë komision, por edhe z. Hado, gjyqtarët e tjerë, nëse paraprakisht ka ndonjë vullnetar për të marrë pjesë në komision. Ndryshe, nëse nuk ka vullnetarë, kalojmë tek pjesa e shortit.

Atëherë, zonja Muçaj?

(Zonja Muçaj aprovon.)

Naureda Llagami: Atëherë, zonja Muçaj u shpreh vullnetare për të marrë pjesë në këtë komision, duke zëvendësuar z. {...}.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Jemi dakord të gjithë?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 15, datë 22.01.2019, të ndryshuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Zoti {...} që ka qenë anëtar, zëvendësohet me zonjën Gentiana Muçaj. Anëtarët e tjerë vazhdojnë të jenë z.Ilir Rusi, z.Klodian Kurushi, znj.Yllka Rupa dhe z.Ridvan Hado.

Faleminderit!

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në shkollën e magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në shkollën e magistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër.

Edhe ky projekt-akt është një detyrim i përvitshëm që ka Këshilli për ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm i cili merret me verifikimin e kandidatëve në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjorë. Ne kemi një rregullore që e kemi për verifikimin e tyre, dhe në zbatim të kësaj rregulloreje e cila ka të bëjë me procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të rekrutimit të këtyre kandidatëve, kemi parashikuar ngritjen e një

komisioni të përvitshëm, që bëhet në javën e parë të shkurtit, i cili përkon fill pasi Këshilli përcakton kuotat. Ky komision merret me verifikimin kryesisht të (në rastin konkret duke qenë se s'kemi kuota për kancelarë) ndihmësve ligjorë që ka propozuar Këshilli, që në mos gaboj kemi propozuar 15 kuota për ndihmës ligjorë.

Sipas procedurës, në këtë rast komisionin e ngremë me short. Kështu që ajo që ne kemi propozuar (dhe që është në rregullore) është që në komision ka dy anëtarë gjyqtarë dhe një anëtar jogjyqtar. Në rastin konkret, në këto komisione përjashtohet kryetarja, duke qenë se kryetarja e ka ndalim ligjor që të shqyrtojë akte individuale.

Unë do ftoja administratën e cila të bëjë gati goglat.

(Sqarohet procedura e shortit shkurtimisht.)

Procedura e shortit si më poshtë:

Në enën e parë futen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve gjyqtarë: znj. Emona Muçi, znj. Gentiana Muçaj, znj. Irena Plaku, z. Klodian Kurushi, z. Markelian Koça, z. Ridvan Hado.

Në enën e dytë futen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve jogjyqtarë: z. Alban Toro, znj. Fatmira Luli, z. Ilir Rusi, znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhen dy emra anëtarë gjyqtarë: e para përzgjidhet znj. Emona Muçi dhe i dyti z. Ridvan Hado.

Përzgjidhet një emër anëtar jogjyqtar: përzgjidhet z. Ilir Rusi.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, e hedhim në votim përbërjen e komisionit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025 (në vijim Komisioni i Përkohshëm).

2. Komisioni i Përkohshëm përbëhet nga tre anëtarë, 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar, të cilët zgjidhen pas zhvillimit të procedurës së shortit. Kryetari i Komisionit të Përkohshëm caktohet nga Kryetari i Këshillit.

3. Përbërja e Komisionit të Përkohshëm, bazuar në pikën 2 të këtij vendimi është:

1. Znj. Emona Muçi.
2. Z. Ridvan Hado.
3. Z. Ilir Rusi.

4. Komisioni i Përkohshëm merr masat për përmbushjen e detyrës së tij bazuar në procedurat dhe afatet e parashikuara në vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 31, datë 31.01.2024 “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Emona Muçi | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Irena Plaku | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 31, datë 31.01.2024 “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025” të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë më pas në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me një ndryshim si rezultat i një ndryshimi që ka bërë Shkolla dhe që detyron Këshillin që të ndryshojë vendimin nr. 31, datë 31.01.2024 “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Po filloj prezantimin e projektvendimit, bashkëlidhur relacionit “Për një ndryshim në vendimin nr. 31, datë 31.01.2024 “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin e datës 31.01.2024 miratoi vendimin “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”.

Në respektim të detajimeve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 53, të Ligjit nr. 98/2016 Këshilli i Lartë Gjyqësor përcaktoi dhe publikojë edhe numrin maksimal të kandidatëve ndihmës ligjorë, që pranohen në formimin fillestar për vitin e ri akademik.

Në pikën 6 të këtij vendimi janë pasqyruar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, që kandidati për ndihmës ligjor duhet të plotësojë për t’u pranuar në provimin e pranimit për formimin fillestar.

Në germën “gj” është parashikuar se: “Të ketë notë mesatare të përgjithshme mbi 7 (shtatë), si dhe notë mesatare mbi 7 (shtatë) për grupin e lëndëve kryesore, ku përfshihen: E drejta civile dhe e detyrimeve, E drejta penale, (Pjesa e përgjithshme dhe pjesa e posaçme), Procedura civile, Procedura penale, E drejta administrative dhe E drejta kushtetuese. Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike.”

Shkolla e Magjistraturës me shkresën e përcjellë më datë 06.02.2024 pranë Këshillit, si dhe vendimin bashkëlidhur datë 29.01.2024, për ndryshimet e fundit në Rregulloren e Brendshme që normojnë procesin e provimit të pranimit për magjistratë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, ka paraqitur një situatë të re e cila nuk ishte parashikuar dhe nuk na ishte vënë në dijeni në kohën kur komisioni bëri relacionin dhe Këshilli mori më pas vendimin.

Sipas këtij vendimi pika “d” dhe “d/1” e Nenit 10, ku parashikohet Regjistrimi i kandidatëve për magjistratë dhe kriteret e pranimit, është ndryshuar si më poshtë:

a) ka notë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë). Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj jashtë vendit, parashikohet një koeficient vështirësie i

barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike;

d/1) Nota mesatare e përgjithshme del nga shumatorja e notave të të gjitha lëndëve të zhvilluara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve e pjesëtuar me numrin total të tyre.

Sipas qëndrimit publik të Shkollës së Magjistraturës ky ndryshim ishte i nevojshëm, pasi: "...Nga analiza dhe vlerësimi i kriterëve të vendosura nga Shkolla për të marrë pjesë në provimin hyrës, bazuar në delegimin e bërë nga ligji siç është sqaruar më lart, u hoq kriteri që konkurrentët të kishin mesatare mbi tetë të lëndëve kryesore dhe atyre të posaçme e të thelluara dhe, u la në fuqi vetëm kriteri që konkurrentët të kenë mesatare mbi tetë të të gjitha lëndëve në programin e studimit për drejtësi që ata kanë përfunduar.

Ky ndryshim konsiderohet mjaft pozitiv në funksion të aksesit të barabartë për të marrë pjesë në konkurrim dhe karakterit objektiv që duhet të mbartë procesi i rekrutimit në Shkollë. Pra janë konsideratat e Shkollës së Magjistraturës.

Analiza jonë lidhur me kriterin e lëndëve kryesore dhe atyre të posaçme e të thelluara, që përbëjnë prej disa vitesh kriterin paralel me kriterin e mesatares së të gjitha lëndëve, konstatoi se programet e universiteteve, shqiptare dhe të huaja, që paraqisnin kandidatët kur regjistroheshin, për shkak të ndryshimeve dhe modeleve të ndryshme ku janë bazuar përgjatë këtyre viteve, nuk kishin uniformitet të lëndëve, të tillë që ta bënin të mundur përcaktimin objektiv të atyre lëndëve që do të konsideroheshin si lëndë kryesore, të posaçme e të thelluara. Nën këtë analizë është vërejtur, jo rrallë herë, se kandidatët janë vendosur në disproporcion me njëri-tjetrin për shkak të numrit të lëndëve me zgjedhje që ata kanë zhvilluar në programin e masterit. Sistemi i Bolonjës, tre plus dy, ka nxitur individualisht përzgjedhjen e lëndëve nga kandidatët në numër të ndryshëm e për rrjedhojë, mesatarja përkatëse varionte në masë, jo të vogël, pikërisht nga numri i lëndëve të tilla të përzgjedhura prej tyre...".

Vlerësimi i Komisionit -

Komisioni, duke mbajtur në vëmendje vendimin e Bordit të Shkollës së Magjistraturës i cili ka ndryshuar kriteret e pranimit për kandidatët magjistratë, me qëllim për të mos cenuar të drejtën e barabartë për të konkurruar në Shkollë për kandidatët për

ndihmës ligjorë, propozon që germa “gj” e pikës 6 të vendimit nr. 31, datë 31.01.2024 të ndryshohet me formulimin si më poshtë vijon:

“Të ketë notë mesatare të përgjithshme mbi 7 (shtatë). Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, jashtë vendit parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike. Nota mesatare e përgjithshme del nga shumatorja e notave të të gjitha lëndëve të zhvilluara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve e pjesëtuar me numrin total të tyre”.

Ky propozim i Komisionit bazohet në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Struktura e projektvendimit -

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet ndryshimi i pikës 6 të vendimit nr. 31, datë 31.01.2024, siç e përmenda edhe më lart.

Ndërsa në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë ftoj anëtarët nëse kanë ndonjë diskutim. Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 6 të vendimit nr. 31, datë 31.01.2024 si më poshtë: “gj) Të ketë notë mesatare të përgjithshme mbi 7 (shtatë). Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, jashtë vendit parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike. Nota mesatare e përgjithshme del nga shumatorja e notave të të gjitha lëndëve të zhvilluara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve e pjesëtuar me numrin total të tyre.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239 – nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235 – nr. 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta sipas rendit të ditës.

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Zoti {...} largohet nga salla dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje (shih fjalën e tij në hyrje të procesverbalit).

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239 – nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235 – nr. 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239 – nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235 – nr. 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

{...}: E nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Nisur nga fakti që në këtë akt përfshihet edhe bashkëshortja ime {...}, unë ju kam bërë me dije, ju kam paraqitur edhe kërkesë për heqje dorë nga gjithë procesi ku përfshihet si kandidate bashkëshortja ime, si dhe eventualisht për të shmangur konfliktin e interesit dhe pretendimet e kandidatëve të tjerë, edhe në vlerësimin e kandidatëve që përplasen me vende dhe në juridiksionin e përgjithshëm. Në dijeninë time kërkesa është miratuar nga ana juaj, kështu që unë do tërhiqem nga pjesëmarrja për këtë pikë të rendit të ditës. Kur të vijë momenti për pikat e tjera mund të më ftoni. Faleminderit!

(Largohet nga salla z. {...}.)

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë vijojmë relatimin e projekt-aktit nga zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

I. Mbi procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239 – nr. 247, datë 24.05.2023.

Në mbledhjen plenare të datës 24.05.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve si dhe referuar nenit 86, shkronja “ç”, i Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar), me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë

24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (9 pozicione të lira në fushën civile).

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë si më lart u përcaktua deri më datë 14.06.2023.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 30 (tridhjetë) kandidatura, të cilët kanë kandiduar në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të prezantuar më lart.

Përgjegjësia e Këshillit për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta ose të specializuara, gjen rregullim edhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në pikën 7, të nenit 48, përcaktohet detyrimi i Këshilli për të bërë verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit nr. 75, datë 23.05.2019. Pikërisht, në respektim të këtij akti, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet respektive nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, të datës 24.05.2023.

II. Mbi procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira, nr. 235, 236, 237 dhe nr. 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në mbledhjen plenare të datës 24.05.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve si dhe referuar nenit 86, shkronja “ç”, i Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe nr. 238 datë 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi 4 pozicione të lira për procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë si më lart u përcaktua deri më datë 14.06.2023.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 13 (trembëdhjetë) kandidatura, të cilët kanë kandiduar në procedurën e ngritjes për pozicionet e lira në Gjykatën Administrative të Apelit të prezantuara si më sipër.

Përgjegjësia e Këshillit për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta ose të specializuara, gjën rregullim edhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikërisht në nenin 48, pika 7 i cili përcakton detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit nr. 75, datë 23.05.2019. Sipas këtij akti nënligjor, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet respektive të përmendura më lart.

Mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në: Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239 – nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit të shpallura me vendimet nr. 235- nr. 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të hapur sipas vendimeve si më sipër të Këshillit, datë 24.05.2023 kandiduan gjithsej 30 (tridhjetë) kandidatë, dhe konkretisht (në krah janë edhe pozicionet):

1. {...}; 2. {...}; 3. {...}; 4. {...}; 5. {...}; 6. {...}; 7. {...}; 8. {...}; 9. {...}; 10. {...}; 11. {...}; 12. {...}; 13. {...}; 14. {...}; 15. {...}; 16. {...}; 17. {...}; 18. {...}; 19. {...}; 20. {...}; 21. {...}; 22. {...}; 23. {...}; 24. {...}; 25. {...}; 26. {...}; 27. {...}; 28. {...}; 29. {...};

30. {...}.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit të hapur sipas vendimeve të mësipërme të Këshillit, datë 24.05.2023 kandiduan gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë, dhe konkretisht:

1. {...}; 2. {...}; 3. {...}; 4. {...}; 5. {...}; 6. {...}; 7. {...}; 8. {...}; 9. {...}; 10. {...}; 11. {...}.

Referuar kandidaturave të paraqitura, rezulton se disa prej kandidatëve kanë kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në gjykatat më të larta/ose lëvizje paralele dhe kanë më tepër se 3 (tre) aplikime në proces. Këta kandidatë ndahen në dy (2) grupe.

Në grupin e parë përfshihen kandidatët të cilët kanë më shumë se 3 (tre) aplikime në proces dhe nuk kanë hequr dorë deri më datë 14.06.2023 – (datë në cilën përfundon afati i paraqitjes së aplikimeve të fundit).

Konkretisht kandidatët:

- {...}, ka aplikuar në pozicionet nr. 239 deri nr. 247 – gjithsej 9 pozicione.
- {...}, ka aplikuar në pozicionet nr. 241, 243, duke pasur ende në garë pozicionet nr.129 dhe nr. 500 – gjithsej 4 pozicione.

- {...}, ka aplikuar në pozicionet 241, 243, 245, duke pasur në proces pozicionet 500, 501 dhe 503 – gjithsej 6 pozicione.

- {...}, ka aplikuar në pozicionin 239, duke pasur në proces pozicionet 502, 503 dhe 504 - gjithsej 4 pozicione.

- {...}, ka aplikuar në pozicionet 239 deri 247, duke pasur në proces pozicionet 502 dhe 503 – gjithsej 11 pozicione.

- {...}, ka aplikuar në pozicionet 245, 246, 247 i cili ka pasur në proces edhe pozicionet nr. 18 dhe nr. 20 të lëvizjes paralele – gjithsej 5 pozicione.

Në grupin e dytë përfshihen kandidatët të cilët në kohën e kandidimit kanë pasur më shumë se 3 (tre) kandidatura në proces dhe kanë hequr dorë nga aplikime të mëparshme pas datës 14.06.2023 – (datë në cilën përfundoi afati i paraqitjes së aplikimeve).

Konkretisht kandidatët:

- {...}, ka aplikuar në pozicionet nr. 241, 243, 247 dhe ndërkohë ka në proces

pozicionet nr. 499, 500 dhe 501 – gjithsej 6 pozicione.

Më datë 21.06.2023 (pra pas datës 14.06.) nëpërmjet postës elektronike z. {...} ka shprehur vullnetin për të hequr dorë nga pozicioni që i përket vendimit nr. 499, dhe mbajtur në konkurrim pozicionet që i përkasin vendimeve nr. 500 dhe nr. 501, që i referohen GJKKO-së, si dhe pozicionin që i përket vendimit nr. 243 për seksionin civil të Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Lidhur me kërkesën për heqjen dorë nga pozicioni nr. 499 – Këshilli nuk është shprehur. Por thashë, kërkesat janë paraqitur jashtë afatit të fundit kohor të përcaktuar në vendimin e Këshillit.

- {...}, ka aplikuar në pozicionet nr. 242, 244 dhe 246, e cila ka pasur në proces pozicionet 15 për lëvizjen paralele në Gjykatën Tiranë dhe pozicionet 503 e 504 për ngritje në detyrë - gjithsej 6 pozicione.

Në datë 23.06.2023 i është drejtuar Këshillit me kërkesën nr. {...} prot, për heqje dorë dhe rikonsiderime pozicionesh, duke u shprehur se vijon aplikimin për pozicionin nr. 242, 503 dhe lëvizjen paralele nr. 15 dhe heq dorë nga pozicionet 504, 244, 246.

Në vijim më datë 07.07.2023 e njëjta kandidate i është drejtuar Këshillit me kërkesë për rikonsiderim të pozicioneve të lira, duke u shprehur se: “Në kushtet kur kërkesa e nisur më datë 23.06.2023 nuk është marrë në shqyrtim dhe në kushtet kur jam duke rikonsideruar edhe një herë kërkesat për pozicionet e lira, duke: shfaqur vullnetin se heq dorë nga aplikimi për lëvizje paralele – shfaq vullnetin se heq dorë nga kërkesa për heqje dorë nga aplikimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, shpallur me vendimin nr. 244. Pozicionet e lira ku vijoj aplikimin janë 503, 242, 244”, - pra një pozicion për GJKKO dhe dy pozicione të lira për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Sa i përket lëvizjes paralele në Tiranë – pozicioni nr. 15 - kërkesa e saj për heqje dorë është miratuar nga Këshilli.

- {...}, ka aplikuar në pozicionin nr. 235, duke pasur në proces pozicionet 449, 502, 503 – gjithsej 4 pozicione.

Me kërkesën nr. {...} prot., datë 21.06.2023 kandidati ka paraqitur kërkesë për

heqje dorë nga pozicioni nr. 503. Për këtë kërkesë për heqje dorë Këshilli është shprehur me vendimin nr. 503, datë 28.09.2023. Bëj me dije se Këshilli në këtë rast është shprehur për heqjen dorë mbi kërkesën e gjyqtarit {...} pasi në një pozicion tjetër ne kemi bërë verifikimin e kriterëve formale dhe kriterëve që lidhen me pasurinë dhe figurën për të. Kështu që kemi bërë kualifikimin për një pozicion dhe do të na duhet që për pozicionin tjetër ku ai kishte hequr dorë, të shpreheshim pa e çuar në Këshill, sepse nuk kishte sens që ta çonim në Këshill kualifikimin apo skualifikimin e gjyqtarit ndërkohë që ai kishte hequr dorë nga pozicioni përkatës. Kjo është arsyeja pse kemi dërguar kualifikimin dhe heqjen dorë në të njëjtën ditë dhe vendimi i Këshillit është marrë në të njëjtën ditë me dy numra të ndryshëm.

Në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës”. Në konsideratë të këtij përcaktimi ligjor, në Njoftimet Publike të datës 25.05.2023, të interesuarve iu është bërë e ditur se:

“Në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë. Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës, qofshin këto procedura të ngritjes në detyrë ose lëvizje paralele.

Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë

kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.

Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar ose kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të së drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.”

Duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore për kandidatët me më tepër se 3 (aplikime), konkretisht: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, {...}, znj. {...}, z. {...}, kandidatët e përmendur më sipër në relacion e kanë paraqitur kërkesën për heqje dorë nga pozicione të mëparshme jashtë afatit të kandidimit për pozicionet e reja në proces. Thënë ndryshe në momentin e aplikimit kanë pasur më tepër se tri kandidatura të vlefshme.

Për një nga këta kandidatë kërkesa për heqje dorë nuk është marrë në shqyrtim nga Këshilli. (z. {...}). Aplikime të vlefshme për këtë kandidat janë aplikimet e bëra më parë në kohë. Konkretisht për z. {...} pozicionet nr. 499, 500 dhe 501. Vullneti i tij për heqjen dorë nga pozicioni nr. 499 do të duhet të verifikohet nga relatori përkatës.

Për z. {...}, pozicionet 449, 502, 503. Vullneti i tij për heqjen dorë nga pozicioni nr. 503 është verifikuar me vendim të Këshillit me nr. 503, datë 28.09.2023.

Për znj. {...} në kushtet kur ka shprehur vullnetin për heqje dorë për lëvizjen paralele – pozicioni nr. 15, Këshilli me vendimin nr. 384, datë 17.07.2023 ka vendosur ndër të tjera: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.15, datë 18.01.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.”

Sa i përket heqjes dorë nga pozicioni 504, vullneti i saj do të verifikohet nga relatori përkatës.

Në konsideratë të parashikimeve ligjore në pikën 6 të Nenit 48, të Ligjit nr.96/2016 për këta kandidatë do të vlejné aplikimet e para.

Sa i përket vullnetit për heqje dorë për z. {...} dhe znj. {...} në kushtet kur nga Këshilli nuk ka një vendim për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë të verifikohet nga relatorët përkatës nëse do të vijojné aplikimet për pozicionet që ata kanë

hequr dorë.

Sa i përket kandidatëve të cilët kanë pasur aplikime të vlefshme të lëvizjes paralele dhe ngritje në detyrë, por për të cilët aktualisht Këshilli ka vendosur transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele, do të verifikohen nga relatori dhe do të vlerësohen nga Këshilli sipas parashikimeve të pikës 5 të Nenit 43 dhe pikës 6 të Nenit 48 të Ligjit nr.96/2016, i ndryshuar gjatë projekt-aktit për verifikimin e plotësimit nga kandidatët të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë.

Referuar kërkesave të kandidatëve rezultojnë disa kandidatë të cilët kanë hequr dorë nga procedura e ngritjes në detyrë, përpara fillimit të verifikimit, konkretisht: z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} – pra për ta nuk fillon procedura e verifikimit sipas këtij vendimi.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në: Gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për kandidatët: znj. {...}, znj {...}, znj. {...}, znj. {...} (për znj. {...} ne pas këtij relacioni kemi sjellë relacionin e radhës të cilin do të prezantojë z. {...} për renditjen dhe ngritjen në detyrë dhe për këtë propozojmë që të mos jetë pjesë e kësaj liste), z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme. Në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 28 (njëzet e tetë) kandidatëve. Themi përsëri që për zonjën {...} ne propozojmë të mos përfshihet në këtë verifikim, pasi më pas ne do të diskutojmë projektvendimin për ngritjen e saj në detyrë në Gjykatën e Apelit të

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i relatorit të parë, zoti Alban Toro. Zoti Toro do të jetë relator për 9 kandidatët të përzgjedhur si vijon: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të dytë, zoti Ridvan Hado. Zoti Hado do të jetë relator për 9 kandidatët të përzgjedhur si vijon: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të tretë, zoti Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për 10 kandidatët të përzgjedhur si vijon: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-aktit së bashku me shortin për relatorët.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1.Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238, datë 24.05.2023 të Këshillit të

Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:
 1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 2. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 3. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
 4. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 5. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 6. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 7. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
 8. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 9. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 10. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 11. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 12. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
 13. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 14. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 15. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 16. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 17. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 18. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 19. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 20. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
 21. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 22. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
 23. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
 24. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
 25. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
 26. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
 27. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
 28. Për kandidaten znj. {...} , relator z. Alban Toro.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça):

9.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9.2 Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të znj. {...}.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Emona Muçi* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)

7. *Irena Plaku* (anëtare)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
10. *Markelian Koça* (anëtar)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Markelian Koça):

9.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9.2 Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të znj. {...}.

(Rifutet në sallë z. Markelian Koça.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër.

Po, Markelian, i cili ka në fakt për të relatuar dy projekt-akte të njëpasnjëshme të cilat janë në një relacion. Kështu që unë ia jap fjalën zotit Koça.

Markelian Koça: Faleminderit znj. Kryetare!

Të nderuar anëtarë, në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës ju kemi paraqitur mbledhjes plenare dy projektvendime, i pari “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” dhe i dyti “Për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të znj. {...}”.

Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji i posaçëm, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, në kuadër të plotësimit të pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit Durrës, tashmë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka hapur disa procedura ngritjeje në detyrë, ndër të tjera, edhe për një pozicion të lirë, me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

Brenda afatit të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor deri më datë 16.04.2021 kanë aplikuar katër kandidatë dhe konkretisht z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i deleguar në Gjykatën e Apelit Korçë, aktualisht i ngritur në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, tashmë e ngritur në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, e transferuar me pëlqim në kohën e kandidimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, tashmë e transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; znj. {...}, e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor si nëpunëse përgjegjëse pranë Njesisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Referuar pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të

përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

Për evidentimin e kandidatëve që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Këshilli realizoi procedurën e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat, të kriterëve të më poshtme:

“përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, të pasurisë dhe figurës.

Ka rezultuar nga verifikimet se për z. {...}, Këshilli ka verifikuar plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit dhe me vendimin nr. 224, datë 02.06.2021, ka vendosur kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Korçë dhe Durrës, për pozicionet e lira ku ka kandiduar.

Për kandidaten znj. {...}, Këshilli ka verifikuar plotësimin prej saj të kriterëve të kandidimit dhe me vendimin nr. 225, datë 02.06.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

Për kandidaten znj. {...}, Këshilli ka verifikuar plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit dhe me vendimin nr. 226, datë 02.06.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

Për kandidaten znj. {...}, Këshilli ka verifikuar plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit dhe me vendimin nr. 229, datë 02.06.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë për pozicionet e lira ku ka kandiduar.

Ndërkohë, krahas procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019, apo vlerësim periodik 2017-2019. Kryerja e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatët në këtë rast, përveç se një detyrim ligjor, është vlerësuar e domodoshme për sa kohë kandidonin për ngritjen në detyrë.

Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës për kandidaten janë kryer verifikimet konform pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Këshilli me vendimin nr. 353, datë 09.09.2021 ka vendosur ndër të tjera: “1.Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Korçë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 129 dhe nr. 132, datë 01.04.2021...”.

Me vendimin nr. 543, datë 23.11.2022 ndër të tjera është vendosur: “1.Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 129 datë 01.04.2021...”.

Me vendimin nr. 114, datë 29.03.2022 ndër të tjera është vendosur: “1.Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 129 datë 01.04.2021...”.

Me vendimin nr. 234, datë 30.06.2022 ndër të tjera është vendosur: “1.Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 129 datë 01.04.2021...”.

Me kualifikimin e kandidatëve, bazuar në pikën 24, të vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), Këshilli, me Vendimin nr. 390, datë 22.09.2021, filloi procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve. Ky vendim është ndryshuar në vijim me vendimin nr. 25, datë 17.01.2022 dhe nr. 13, datë 18.01.2024 që lidhet me ndryshimin e relatorit të procedurave të përzgjedhjes.

Në rrugë elektronike, vendimi i është bërë i ditur kandidatëve të cilët nuk kanë parashtruar kundërshtime apo kërkesë për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Ndërkaq ka pësuar ndryshime radha e kandidatëve, në kuptimin që gjatë procedurës së përzgjedhjes kandidati {...} paraqiti kërkesë për heqje dorë nga kandidimi në këtë pozicion. Këshilli, me vendimin nr. 354, datë 27.07.2022 ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për

pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi”.

Gjithashtu me vendimin nr. 373, datë 13.07.2023 vendosi ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të kandidatës znj. {...}.

Gjatë procedurës së përzgjedhjes paraqiti kërkesë për heqje dorë nga kandidimi në këtë pozicion edhe kandidatja, znj. {...}. Këshilli, me vendimin nr. 37, datë 31.01.2023 vendosi: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi”.

Në këto rrethana procedurale, kandidatë e vetme e mbetur në këtë pozicion është znj. {...}. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të vendimit 70/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës të kandidatës, që gjendej në dosjen e saj personale apo në praktikën dokumentare të procedurës së verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu nga ana e relatorit janë administruar edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për të.

Ka rezultuar se lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...} u konstatua se:

a) Sipas vendimit të Këshillit nr. 60, datë 31.01.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 393 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim;

b) Sipas vendimit të Këshillit nr. 155, datë 29.03.2023, kandidatja është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 391 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatës znj. {...} të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 60, datë 31.01.2023 dhe nr. 155, datë 29.03.2023, u konstatuan të

jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim. Lidhur me këtë, konstatohet se vendimet si më lart të Këshillit i janë dërguar për njoftim kandidates në adresën elektronike të paraqitur nga ajo vetë, si dhe në rrugë postare, me shkresën përcjellëse dhe ndaj tyre nuk është ushtruar ankim.

Sa më lart, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendimin përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 05.02.2024, sikurse përcaktohet në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidatin në këtë procedurë

përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Së bashku me projektvendimin e renditjes, relatori përcjell edhe projektvendimin për ngritjen në detyrë të kandidatës znj. {...}.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ngarkesa e znj. {...} është 499 çështje. Ndërkohë ka në shqyrtim në fazën e konkluzioneve përfundimtare 1 çështje të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (data 7 shkurt është caktuar seanca); si edhe një çështje në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – seancë paraprake - datë 5 shkurt.

Ndonëse u morën informacionet përkatëse nga gjykatat lidhur me ngarkesën e znj. {...} vlerësohet se data 19.02.2024 është një afat optimal për t'u përcaktuar në vendim. Kjo periudhë konsiderohet e mjaftueshme gjatë të cilës znj. {...} do të duhet të dorëzojë detyrën pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të ligjit specifik, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (në të cilën propozohet të ngrihet në detyrë), Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në të cilën ka caktimin e përhershëm), Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (në të cilën ushtron funksionin sipas vendimit të Këshillit për transferimin me pëlqim) dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në të cilën ushtron funksionin për çështje gjyqësore të veçanta, caktuar nga Këshilli);

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja e tij në fuqi menjëherë dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Koça!

Atëherë, kalojmë me projekt-aktin e parë që është miratimi i renditjes, ku në rastin konkret kemi vetëm një kandidat. Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin e dytë i cili ka të bëjë me ngritjen në detyrë, pra në eventualitetin që kemi vetëm një kandidat, kalojmë në aktin e dytë që është ngritja në detyrë e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të znj. {...}.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 19.02.2024.

3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.02.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 04.12.2023, 06.12.2023, 07.12.2023, 12.12.2023, 14.12.2023, 26.12.2023 dhe 28.12.2023.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:05 dhe mbaroi në orën 13:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Emona Muçi*** (anëtare)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Irena Plaku*** (anëtare)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
10. ***Markelian Koça*** (anëtar)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Baisa Sefa, Këshilltare e Kabinetit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala, eksperte e EWMI-INL.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. Edmond Hoxhaj, Birn (në sallë).

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 04.12.2023, 06.12.2023, 07.12.2023, 12.12.2023, 14.12.2023, 26.12.2023 dhe 28.12.2023.

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin e fundit për mbledhjen e sotshme që ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat administrata jua ka vënë në dispozicion. Nëse nuk kemi diskutime kalojmë.

Procedura që ndiqet është që do shprehni dakordësinë vetëm për ato që keni qenë prezent. Kështu që kalojmë në votim miratimin e procesverbaleve.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord për procesverbalet e datës 12.12.2023, 14.12.2023, 26.12.2023 dhe 28.12.2023. Në procesverbalet e tjera s’kam qenë anëtare.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Edhe unë me qëndrimin e Gentës, për procesverbalet e datës 12.12.2023, 14.12.2023, 26.12.2023, 28.12.2023. Në tre mbledhjet e tjera nuk kam qenë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Të njëjtin qëndrim edhe unë në lidhje me dakordësinë për procesverbalet e datave 12.12.2023, 14.12.2023, 26.12.2023, 28.12.2023 për të cilat kam qenë prezent dhe për të tjerat nuk mund të shprehem pasi nuk kam qenë anëtare në atë periudhë. Faleminderit!

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 04.12.2023, 06.12.2023, 07.12.2023, 12.12.2023, 14.12.2023, 26.12.2023 dhe 28.12.2023.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, me kaq e mbyllim mbledhjen e sotshme.

Faleminderit për kontributin!

Mirë u takofshim!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor